



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva Obrazovanja Nauke i
Tehnologije-Ministry of Education Science & Technology*

Kabineti i Ministrit /Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

UDHËZIM ADMINISTRATIV
ZBATIMI I PLANIT DHE PROGRAMIT PËR ARSIMIN PROFESIONAL
FUSHA: ADMINISTRATË PËR NIVELIN E PARË (KL.X, XI)

NUMËR: 26/2008

DATË: : 19.08.2008

Në bazë të Kapitullit VI, neneve 93 (4) dhe 97 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6.1 paragrafi (d) të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë nenit 6, 8, 11 të Ligjit mbi Arsimin dhe Aftësimin Profesional, si dhe nenit 25 paragrafit 7 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ (më tutje UA):

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është zbatimi i planit dhe programit mësimor për shkollat profesionale, nivelin e parë (kl.X, XI).

Neni 2

Planprogrami

Plani dhe programi i ri për nivelin e parë (kl.X, XI) fusha: Administratë, *profilet: asistent i administratës, asistent juridik, organizator i aktiviteteve shoqërore*, i është bashkangjitur këtij Udhëzimi administrativ.

Neni 3
Zbatueshmëria

Me zbatimin e planit dhe programit të nivelit të parë (kl.X, XI), zëvendësohen planet dhe programet e deritashme të kl.X,XI.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi me fillimin e vitit shkollor 2008/2009.

Enver Hoxhaj, ministër